



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVES + REPUBLICA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Drejtoria e Financave, e Ekonomise dhe e Zhvillimit  
Direktorijati za Financije, Ekonomiju i Razvoj  
Mojac, Ekonomiye Kalkinma Muduriyati

104/02 Nr. 117 Dt. 09.06.2023



**Kuvendi Komunal Prizren**  
Skupstina Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

# **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026**

Qershor 2023



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova  
 Republic of Kosova



**Kuvendi Komunal Prizren**  
 Skupstina Opstina Prizren  
 Municipal Assembly Prizren

## **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE** **2024 - 2026**

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Prizrenit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2024-2026, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2024/01 për Komunat si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2024 dhe parashikimet për 2025-2026. Ky dokument i ka kushtuar rendesite të veqante alokimit të buxhetit nga aspekti i barazise gjinore. Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponente barazise gjinore duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punesimit, përfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj. të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prizrenit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mireqenies sociale dhe familjare me fokus të veqante në grupet në nevojë dhe barazine gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024– 2026 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal



## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burimeve dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2023-2025 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## **Prioritet e Komunës**

### **II**

#### **1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi te barabarta për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit e grave dhe burrave fermere.
- 

#### **2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile me theks te vecante te gratë dhe grupet ne nevojë
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive per vajza dhe djem.

#### **3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

Ne baze te hulumtimit te nevojave te grave dhe burrave Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Ofrimi i mundësive per pjesëmarrje aktive te grave dhe grupeve ne nevojë;

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

#### **4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe nevojave te grave dhe burrave.**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:



Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve për gratë dhe burrat

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2024-2026 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### III.

#### **Korniza Fiskale Komunale**

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtë për drejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përket edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë të grave dhe burrave në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Prizrenit në periudhën afatmesme buxhetore 2024-2026 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

## ❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2024 – 2026 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve “ dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2024 – 2026 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2024/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve .

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afat mesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vite tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

### Deklarata e MISIONIT

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

## ❖ Objektivat e Komunës së Prizrenit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit
- Hartimi i planit zhvillimor të Komunës dhe planeve rregullative në zonat urbane
- Kthimi i të zhvendosurve në prona të veta
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Sportit dhe Rinisë
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Përmirësimi i nivelit të kooperimit ndëretnik
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor
- Riatdhesimi i qytetarëve të kthyer.

### Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

#### Objektivi i përgjithshëm:

- Krijimi i politikave dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive që gjatë hartimit dhe zbatimit te tyre te behet promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave;

### Objektivi specifik:

- Sigurimi i mjediseve te favorshme per zhvillimin e aktiviteteve sportive te vajzave dhe grave duke mundesuar rritjen e pjesemarrjes se tyre ne jeten sportive, dhe tejkalimin e normave diskriminuese sociale.

### Indikatori:

- Të nxitet krijimi i klubeve sportive vetëm për gra dhe vajza, ku në vitin 2022 ishte vetëm një klub i udhëhequr nga gratë, në vitin 2023 numri u shtua në 2, deri në vitin 2025 të jenë së paku 5 klube sportive të udhëhequra nga gratë dhe vajzat.

### ❖ Objektivat shtetërore

- Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; rritja e numrit të grave përfituese e subvencioneve komunale për 10% me vlere (te shtohet vlere) ne raport me 2023(te ceket sa ka qene vlere e subvencioneve qe i kane përfituar grat).
- Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit; Rritja e numrit të grave të punsuara për 10% ne raport me vitin 2023. (ne kushte barabarta perparsi per gra) (këtu te shtohet % ekzistuese te punësuarve femra dhe meshkuj per vitin 2023)
- 
- Zhvillimit të kapitalit njerëzor; si dhe potencialin gjithëanshem te grave dhe burrave. / Rritja e numrit të përfituesve të bursave studentore për 50% femra meshkuj ne raport me vitin 2023 . (këtu te shtohet 5 e përfituesve femra dhe meshkuj)
- **Krijimi i infrastrukturës së pershtatshme për zhvillimin e aktiviteteve Kulturore, Rinore dhe Sportive: Ndërtimi i objekteve të ndryshme ne baze te nevojave burrave, grave, vajzave dhe djemve duke mundesuar qasje te barabarte ne shfrytezim);**
- Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Banimi social, mbështetja financiare për strehimoren e grave (vazhdimi i marveshjes memorandum mirekuptimi) funksionalizim i shtepise se pleqve.
- Mbështetje lehonave.

Siq mund të shihet objektivat e Komunës janë të lidhura ngusht me objektivat e shtetit të Kosovës



### **Ky dokument ka për qëllim të:**

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritare të Qeverisë.
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

### **Objektivat:**

#### **a). Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve**

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

#### **b). Rritja e shpejtë e të ardhurave**

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

#### **c). Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve**

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Përmirësimi i specifikimit për mallra dhe shërbime
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë

**d). Zhvillimi i aftësive**

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
- Përdorim i gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve

**e). Të sigurohet disiplina financiare**

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Ekzistenca e kontrolleve interne – Auditori i Brendshëm
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme ( Cash Plani )

**f). Ekonomia**

- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural

**Programet**

**a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca**

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat Gjenerimi i statistikave gjinore
- 
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

**b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave**

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme
- Ngarkesa të reduktuara

### c. Ristrukturimi organizativ

- Shqyrtimi i strukturës organizative **Organogrami i Ri**

#### Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Kujdesi ndaj palëve (Hapja e Zyrës Pritëse)
- Shqyrtimi i planit të punës 2023
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2024
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2025-2026
- Përgatitja e planit urbanistik , rregullativ dhe detal
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të dhënave dhe përdorimi
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

#### Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë:

- (a) **LIMITET** e grandeve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna
- (b) Buxheti duhet të jetë I **BALANCUAR**. Kjo do të thotë se Komuna **NUK MUND** të bëjë planin për shpenzime e cila tejkalon grandet e lejuara dhe nuk mund të përgatisë buxhetin deficitar.

#### 1.1. Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale ( politikës së të ardhurave si nga grandit i qeverisë, të hyrave vetjake komunale si dhe shpenzimeve. Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2024 – 2026 është parapare ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve publike – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së e deri të marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal . P sh.

- Kontroll më i ngushtë dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal.
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës



### Korniza makroekonomike e Komunës është sipas Qarkores nr. 2023/01 për Komuna

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është në përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH).

Në përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Grandi Qeveritar dhe Të Hyrat Vetjake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës, me që nga të hyrat e përgjithshme nuk janë mjaftueshme duke u bazuar në kërkesat sipas Drejtorive të Komunës sonë.

### BUXHETI NGA GRANTI DHE TE HYRAT VETJAKE PER VITIN 2024-2026 SIPAS QARKORES BUXHETORE NR. 2024 /01

Organizata buxhetore	Aprovimi	Planifikimi	% e rritjes së buxhetit	Diferenca 2023-2024	Projeksioni	Projeksioni
	2023	2024			2025	2026
Administrata e përgjithshme	25,412,893	28,389,830	112	2,976,937	30,540,761	32,561,785
Arsimi	16,434,848	19,383,401	118	2,948,553	19,964,902	20,563,850
Shëndetsia	6,513,469	6,542,493	100	29,024	6,869,617	7,213,098
Fin.Q.H.Pz.Q.K.Zym Kesh. I Hoqes se madhe	44,810	51,532		6,722		
Financimi për teatro	141,866	263,947		122,081	263,947	263,947
Financimi për shërbimet rezidenciale	540,500	630,000		89,500	615,000	615,000
Huamarrja per Arsim				0		
Huamarrja per shendetesi				0		
Grantet	49,088,386	55,261,203	113	6,172,817	58,254,227	61,217,680
Te hyrat vetanake	8,403,558	10,193,294	121	1,789,736	10,605,106	11,135,967
<b>Totali:</b>	<b>57,491,944</b>	<b>65,454,497</b>	<b>114</b>	<b>7,962,553</b>	<b>68,859,333</b>	<b>72,353,647</b>

## Parashikimi i të hyrave vetjake komunale

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cilat të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

### Të Hyrat e Komunës përbëhen nga:

- Tatimi në pronë
- Burimi i tatimit në tokë
- Taksat për ushtrim te veprimtarisë afariste
- Taksat për lejen për shërbime profesionale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për certifikata
- Taksa për menaxhimin e mbeturinave
- Qiraja nga objektet
- Bashkë-pagesat në arsim
- Bashkë-pagesat në shëndetësi
- Renta e tokës
- Të hyra tjera<sup>1</sup>♦

## KORNIZA KOMUNALE E SHPENZIMEVE BUXHETORE

### Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme buxhetore të shpenzimeve përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makroekonomik dhe treguesit fiskal si dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar të vitit 2023.

Kjo kornizë paraqet parashikimin tre vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit si dhe të granteve të qeverisë të cilat pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i Granteve nga MEF-i.



**VLERËSIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE 2024-2026**

Programet	Planifikimi 2023	2024	2025	2026
Zyra e Kryetarit	3,771,242	4,279,274	4,484,902	4,691,689
Zyra e Kuvendit Komunal	230,974	450,000	450,000	450,000
Auditori		43,174.00	43,325.00	43,464.00
Administrata dhe personeli	2,844,097	2,539,395.00	3,074,571.00	3,297,582.00
Inspektimet	302,830	416,117.00	395,351.00	398,850.00
Buxheti dhe financat	714,310	892,676.00	1,108,250.00	1,159,251.00
Shërbimet publike	14,458,201	17,212,589.00	17,504,106.00	20,287,397.00
Zjarrefiksit	868,926	1,007,340.00	1,021,682.00	836,875.00
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	73,288	104,072.00	106,982.00	108,654.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural	1,233,781	885,544.00	806,260.00	680,580.00
Zhvillimi ekonomik	878,634	661,142.00	642,890.00	844,150.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	1,198,357	815,712.00	837,989.00	849,998.00
<u>Shëndetësia dhe mirëqenia sociale[1]</u>	6,743,469	8,249,025.00	8,647,965.00	8,417,965.00
Administrata e shëndetsise	36,176	42,580.00	44,820.00	49,890.00
Sherbimet sociale	1,921,160	1,690,620.00	2,066,400.00	1,496,980.00
Sherbimet rezidenciale	540,500	404,000.00	404,000.00	604,000.00
Kultura, rinia dhe sportet	1,187,210	2,421,939.00	2,780,125.00	2,343,597.00
Teatri profesional	221,866	340,875.00	358,012.00	362,100.00
Arsimi dhe shkenca(sh.fill.dhe te mesme)	16,904,848	19,712,552.00	20,142,565.00	21,302,231.00
Administrata e Arsimit	3,215,835	3,106,182.00	3,745,008.00	3,920,154.00
Kadastër gjeodezi dhe pronë	146,240	179,689.00	194,130.00	208,240.00
<b>TOTALI</b>	57,491,944	65,454,497	68,859,333	72,353,647



## PARASHIKIMI I TE HYRAVE VETANAKE SIPAS VITEVE 2024-2026

Nr.	Përshkrimi	2023 Plani	2024 Vlerësimi	2025 Vlerësimi	2026 Vlerësimi
a	b	d	e	f	g
1	<b>TË HYRAT KOMUNALE TOTALE</b>	<b>8,403,558</b>	<b>10,193,294</b>	<b>10,605,106</b>	<b>11,105,967</b>
1.1	<b>TË HYRAT VETANAKE</b>	<b>8,403,558</b>	<b>10,193,294</b>	<b>10,605,106</b>	<b>11,105,967</b>
1.1.1	<b>Tatimi në pronë dhe toke</b>	<b>3,497,307</b>	<b>3,620,000</b>	<b>3,720,000</b>	<b>3,820,000</b>
	Burimi I tatimit ne tokë				
1.1.2	<b>Taksat komunale</b>	<b>3,656,251</b>	<b>5,073,294</b>	<b>5,325,106</b>	<b>5,655,967</b>
	Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve)	420,000	420,000	420,000	450,000
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	420,000	560,000	580,000	590,000
	Taksat e pajisjeve motorike	530,000	520,000	540,000	590,000
	Lejet për ndërtesa	420,000	1,600,000	1,670,000	1,705,967
	Taksa nga menagjimi I mbeturinave	1,666,251	1,773,294	1,915,106	1,970,000
	Taksat tjera komunale	200,000	200,000	200,000	350,000
1.1.3	<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>1,150,000</b>	<b>1,150,000</b>	<b>1,180,000</b>	<b>1,220,000</b>
	Ngarkesat regullatore				
	Të hyrat nga qiraja	450,000	450,000	480,000	520,000
	Bashkë-pagesat për arsim	470,000	470,000	470,000	470,000
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	230,000	230,000	230,000	230,000
	Ngarkesat tjera komunale (gjobat)				
1.1.4	<b>Të hyrat tjera</b>	<b>100,000</b>	<b>350,000</b>	<b>380,000</b>	<b>410,000</b>
1.1.5	<b>Shitja e aseteve</b>				
1.1.6	<b>Grantet dhe donacionet</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
	Vendore				
	Të huaja				
1.2	<b>TRANSFERET QEVERITARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
1.2.1	<b>Granti i përgjithshëm</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
1.2.2	<b>Granti specifik për arsim</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
1.2.3	<b>Granti specifik për shëndetësi</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
1.2.4	<b>Grantet dhe transferet tjera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	

**LIMITET FILLESTARE SIPAS QARKORES BUXHETORE Nr.2024 /01 NGA  
MEF-i:**

	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>
Granti për administratën Komunale	26,140,069	29,335,309	31,419,708	33,440,732
Granti për Arsim	16,434,848	19,383,401	19,964,902	20,563,850
Granti për Shëndetsi	6,513,469	6,542,493	6,869,617	7,213,098
<b>Gjithsej granti nga BKK</b>	<b>49,088,386</b>	<b>55,261,203</b>	<b>58,254,227</b>	<b>61,217,680</b>
Të hyrat vetanake nga Buxheti I KK-Prizren	8,403,558	10,193,294	10,605,106	11,135,967
<b>Totali I buxhetit Komunal-Prizren</b>	<b>57,491,944</b>	<b>65,454,497</b>	<b>68,859,333</b>	<b>72,353,647</b>

Nga përmbledhja e shpenzimeve për KK- Prizren shihet se për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime prej 65.454.497 euro, sipas qarkores së parë 2024/ 01 nga MEF-i.



## PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITIN 2024

	KK PRIZREN (ADMINISTRATA E PERGJITHËSHME)		Stafi 2024	Pagat &Meditjet	Mallrat dhe sherbimet	Sherbimet Komunale	Subvencione &transfere	Investime Kapitale	Totali
1	Zyra e Kryetarit	granti	34	352,198				0	352,198
		te hyrat					3,970,250		3,970,250
2	Asambleja Komunale	granti		450,000					450,000
		te hyrat							0
3	Administrata dhe Personeli	granti	81	596,154	1,000,000	321,413		400,000	2,317,567
		te hyrat			221,828		0		221,828
4	Inspeksioni	granti	23	336,117	50,000				386,117
		te hyrat			30,000				30,000
5	Buxhet dhe financa (granti)	granti	41	337,676	450,000			5,000	792,676
		te hyrat			100,000				100,000
6a	Sherbimet PUBLIKE	granti	19	184,010	3,000,000	250,000		9.067.363	12.497.373
		te hyrat			578,289	250,000		3.882.927	4.711.216
6b	Emergjencia	granti	63	507,340	30,000			450,000	987,340
		te hyrat			20,000				20,000
7	Zyra e Komuniteteve	granti	7	54,072	50,000				104,072
		te hyrat							0
8	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	granti	20	142,144	243,400			500,000	885,544
		te hyrat							0
9	Zhvillim Ekonomik	granti	4	31,114	80,000	0		550,026	661,140
		te hyrat							0
10	Kadastër dhe Gjeodezi	granti	19	157,689	22,000	0			179,689
		te hyrat							0
11	Planifikimi Urban dhe Mjedis	granti	14	115,712	580,000	0		100,000	795,712
		te hyrat			20,000				20,000
13	Kulturë, Rini dhe Sport	granti	22	208,939	1,000,000			1,193,000	2,401,939
		te hyrat			20,000				20,000
14	TEATRI	granti	21	231,125	80,000		29,750		340,875
		te hyrat							0
15	Sherbimet Sociale	granti	28	255,620	600,000			635,000	1,490,620
		te hyrat			200,000				200,000
16	Sherbimet rezidenciale	granti	24	219,000	150,000	20,000		15,000	404,000
		te hyrat							0
	Administrata Shend.	granti	5	42,580		0			42,580
		te hyrat							0
	Administrata e Arsimit	granti	16	156,000	693,754			1,858,356	2,708,110
		te hyrat			200,000				200,000
	<b>GRANTI I PERGJITHESHEM</b>		<b>441</b>	<b>4,377,490</b>	<b>8,029,154</b>	<b>591,413</b>	<b>29,750</b>	<b>14.773.745</b>	<b>27.801.552</b>
	<b>TE HYRAT</b>			<b>0</b>	<b>1,390,117</b>	<b>250,000</b>	<b>3,970,250</b>	<b>3.882.927</b>	<b>9.493.294</b>
			<b>441</b>	<b>4,377,490</b>	<b>9,419,271</b>	<b>841,413</b>	<b>4,000,000</b>	<b>18,656,672</b>	<b>37,294,846</b>



17	Kujdesi primar shendetesor		475	4,937,965	1,661,060	150,000	0	1,500,000	8,249,025
17A	Shërbimet e kujdesit primar shendetesor (GRANTI I SHENDETSISE)	granti	475	4,747,965	1,621,060	150,000	0	1,500,000	8,019,025
	TE HYRAT E SHENDETSISE	hyrat		190,000	40,000				230,000
18	Arsim dhe shkencë		2,309	18,044,074	1,408,477	260,003	0	198,072	19,910,626
18A	Arsimi fillor	granti	1875	14,375,377	1,008,477	147,368		198,072	15,729,294
18B	Arsimi I mesem	granti	380	3,218,697		62,135			3,280,832
	Arsimi parafillor /Qerdhja e femijeve/		54	380,000		50,500			430,500
	Asistent per femije me nevoja te vecanta spec,IT;keshilltar								0
	pensionimet sipas ligjit; pagat jubilarë	granti							0
	Push.e lindjes	granti							0
	GRANTI PER ARSIM	granti	2,309	17,974,074	1,008,477	260,003	0	198,072	19,440,626
	TE HYRAT E ARSIMIT	hyrat		70,000	400,000				470,000
	GJITHSEJ GRANTI		3,225	27,099,529	10,658,691	1,001,416	29,750	16.471.817	55.261.203
	GJITHSEJ TE HYRAT			260,000	1,830,117	250,000	3,970,250	3,882.927	10.193.294
	<b>TOTALI 2024</b>		<b>3,225</b>	<b>27,359,529</b>	<b>12,488,808</b>	<b>1,251,416</b>	<b>4,000,000</b>	<b>20,354,744</b>	<b>65,454,497</b>

Buxheti sipas Qarkores 2024/01

65,454,497

## PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitin 2024-2026, nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit sipas proceseve buxhetore të zhvilluara dhe të aprovuara duke e marre parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Në tabelën e më poshtme paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me buxhet të vitit 2024 me financim nga të hyrat vetjake si dhe nga mjetet e Grantit të destinuara për shpenzime kapitale me të dhëna për përfituesit gra dhe burra.

Gjithashtu në këtë tabelë do të paraqesim edhe projektet e planifikuara për vitin fiskal 2025-2026 nga të Hyrat vetanake të parashikuara si dhe nga mjetet e Grantit për shpenzime kapitale.

Kjo listë e planifikuar për vitin 2024-2026 mund të plotësohet edhe me projekte të tjera por edhe mund të largohen disa nga planifikimi por ky plotësim dhe modifikim i projekteve mbetet për më vonë. Këto plotësime dhe modifikime mund të bëhen nga Drejtoritë përkatëse gjatë shqyrtimeve për prioritet të Investimeve Kapitale si dhe gjatë diskutimeve me Komitetin për politikë dhe financa si dhe me struktura tjera Komunale, por gjithashtu edhe në takimet me qytetarë.



## KËRKESAT E PRANUARA PËR PROJEKTET KAPITALE SIPAS DREJTORIVE PER VITIN 2024-2026

	EMERTIMI I PROJEKTEVE	KODI I PROJEKTEVE EKZISTUESE DHE PROJEKTET E REJA	SHUMA E PLANIFIKUAR 2024	SHUMA E PARASHIKUAR 2025	SHUMA E PARASHIKUAR 2026
	<b>KK - PRIZREN</b>				
	<b>TOTALI I PROJEKTEVE KAPITALE - PRIZREN</b>		<b>€ 20,354,744.00</b>	<b>€ 22,433,353.00</b>	<b>€ 24,466,850.00</b>
	<b>180 SHERB.PUBLI.MBROJT.CIVIL.EMER</b>				
1	Rregullimi i trotuareve në unazen e qytetit	52398	€ 300,000.00	€ -	€ -
2	Ndërtimi I rrugeve,kanalizimit,ujsjellesit dhe ndriçimi publik në lagjen "Dardania 2"	52691	€ 1,000,000.00	€ -	€ -
3	Shtimi I kapacitetit te ujit të pijës në Komunën e Prizrenit	53833	€ 300,000.00	€ 2,040,099.47	€ 2,731,850.00
4	Vendosja e ujëmatësve dhe pusëtës për konsumator në pronë publike-Zhur Dobrushtë , Vërmicë,Shkozë,Vlashnje,Muradem,Kobajë dhe Nashec	52402	€ 500,000.00	€ 1,500,000.00	€ 2,000,000.00
5	Rehabilitimi investiv i rrugëve ne qytetin e Prizrenit dhe fshatrave-intervenime ditore në qindra rrugë	53823	€ 750,000.00	€ 2,200,000.00	€ 2,200,000.00
6	Rehabilitimi I ujesjellesit në rrugën "Edit Durham"	52403	€ 200,000.00	€ -	€ -
7	Ndërtimi I rrugës tranzitore-kryqëzimi me autostrade,	52101	€ 585,100.00	€ -	€ -
8	Ndërtimi I infrastrukturës rrugore në zonën nga Benafi deri në Ortokoll,	51153	€ 50,000.00	€ -	€ -
9	Ndërtimi i ujesjellesit në Lubizhdë të Prizrenit , ndërtimi i bazenit të ri.	51105	€ 510,000.00	€ -	€ -
10	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugëve në lagjen "Bajram Curri	53805	€ 150,000.00	€ 200,000.00	€ 200,000.00
11	Ndrtimi i Infrastrukturës (rruge,kanalizim,ujsjelles etj) në lagjen "Jeta e re".	52100	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ 350,000.00
12	Instalimi i ndriçimit te ri publik dhe riparimi I ndriçimit ekzistues	82446	€ 300,000.00	€ 400,000.00	€ 500,000.00
13	Rehabilitimi dhe ndertimi i rrugeve me asfalt në qyte dhe fshatra ( aty ku paraqitet nevoja për intervenime)	53818	€ 400,000.00	€ 1,500,000.00	€ 2,200,000.00
14	Rehabilitimi, ndërtimi, trotuareve dhe shesheve me elemente betoni ( intervenimi ne ato vende ku paraqitet nevoja) në qytet dhe fshatra të Prizrenit	53817	€ 400,000.00	€ 500,000.00	€ 600,000.00
15	Rehabilitimi dhe mirembajtja e sistemit te kanalizimit dhe ujesjellesit në qytetin e Prizrenit dhe fshatra të Prizrenit ( aty ku eshte nevoja për intervenim)	53834	€ 250,000.00	€ 300,000.00	€ 350,000.00
16	Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatra të Komunës së Prizrenit ( aty ky paraqitet nevoja per intervenim)	53826	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ 400,000.00
17	Pastrimi i pusëtave dhe ujëmbledhsave në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit-në pjesët kryesore të qytetit të Prizrenit	53823	€ 200,000.00	€ 200,000.00	€ 300,000.00
18	Trajtimi dhe rrethimi i hapsirave me interes publik në disa lokacione te Prizrenit	53824	€ 100,000.00	€ 150,000.00	€ 200,000.00
19	Projekte ambientale (parqe, rrethoja,karrika, ndriqim dekorativ etj) në pjesën kryesore të Qytetit të Prizrenit	53811	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ 400,000.00
20	Ndërtimi i projekteve infrastrukturore-rrugeve,kanalizimit,ujsjellesit,mure mbrojtëse,urave etj, projekte te vogla në Qytetin e Prizrenit dhe fshatrave	53804	€ 300,000.00	€ 500,000.00	€ 600,000.00
21	Ndërtimi i Infrastrukturës (rrugë,kanalizim,ujsjelles etj) Tusus	52104	€ 200,000.00	€ 250,000.00	€ 300,000.00
22	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen "Arbana" në qytetin e Prizrenit	53808	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ 400,000.00
23	Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë	52115	€ 200,000.00	€ -	€ -
24	Ndërtimi I rrugës Qafa e Kushninit-Stanet e Struzhës	52127	€ 122,000.00	€ -	€ -
25	Ndërtimi i rrugeve lokale dhe kanalizimit ne Randobrave	87692	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ -
26	Ndërtimi iinfrastruktures në Zojz, rrugët dhe kanalizimi	52593	€ 200,000.00	€ -	€ -
27	Rregullimi I përrockes në fshatin Piranë	48362	€ 100,000.00	€ -	€ -
28	Ndërtimi i rrugeve dhe kanalizimit në fshatrat e Zhupës	53809	€ 150,000.00	€ 200,000.00	€ 250,000.00
29	Ndërtimi i rrugëve lokale në Korishë	40602	€ 100,000.00	€ 150,000.00	€ 150,000.00
30	Rehabilitimi i infrastrukturës (rrugët , kanalizimi ,ujsjellesi, ndriçimi publik etj) , në Zhur	49724	€ 100,000.00	€ 200,000.00	€ 250,000.00
31	Ndërtimi i infrastrukturës në Gjonaj	49728	€ 100,000.00	€ 150,000.00	€ 200,000.00
32	Rregulliimi i infrastrukturës në Zym, kanalizimet dhe rrugët	51117	€ 100,000.00	€ -	€ -
33	Asfaltimi i rrugës Sërbicë e Eperme-Smaç	52098	€ 70,000.00	€ -	€ -
34	Asfaltimi i rrugës Medvec-Smaç	52103	€ 70,000.00	€ -	€ -



35	Ndërtimi i infrastruktures (rrugë,kanalizim,ujesjelles etj) në rrugen Atmaxhë	52134	€ 50,000.00	€ -	€ -
36	Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në Lagjen "2 Korriku"	52399	€ 70,000.00	€ 150,000.00	€ 200,000.00
37	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në rrugen "Nënë Tereza"	52405	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ -
38	Ndërtimi i ndriçimit publik në Korishë	52408	€ 200,000.00	€ -	€ -
39	Ndërtimi i kanalizimit në Landovicë	52468	€ 70,000.00	€ -	€ -
40	Rregullimi i ndriçimit publik në Lubizhdë të Hasit	52474	€ 300,000.00	€ -	€ -
41	Ndërtimi i rrugës Vlashnje-Kobajë	52500	€ 70,000.00	€ -	€ -
42	Ndërtimi i rrugës Billushë-aksi rrugor Zhur-Drash	52507	€ 150,000.00	€ -	€ -
43	Ndërtimi i infrastrukturës në Malesi të re -kanalizimi dhe rrugicat dhe ujësjellesi dhe Ndërtimi i kanalizimit në Lutogllavë	52543	€ 100,000.00	€ -	€ -
44	Ndërtimi i rrugës Shpenadi-Lubizhdë	52543	€ 70,000.00	€ -	€ -
45	Ndërtimi i rrugës në Sërbicë e Poshtme-Zojz	52548	€ 70,000.00	€ -	€ -
46	Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në Rrugen Romajë-Lukinaj	52595	€ 100,000.00	€ -	€ -
47	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Grazhdanik	52701	€ 50,000.00	€ -	€ -
48	Ndërtimi i rrugëve,kanalizimit dhe ndriçimit publik në Krajk	52701	€ 70,000.00	€ -	€ -
49	Ndërtimi i kanalizimit të hapur,mureve mbrojtëse dhe rregullimi i rrugicave në fshatin Krushë e Vogel	52728	€ 70,000.00	€ -	€ -
50	Ndërtimi i kanalizimit , rrugëve dhe rregullimin e përrockes në Jeshkovë	52729	€ 100,000.00	€ -	€ -
51	Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Gjonaj dhe Korishë dhe vende tjera	53838	€ 100,000.00	€ -	€ -
52	Ndërtimi i infrastrukturës në Romajë, rrugët dhe ndriçimi publik	52730	€ 60,000.00	€ -	€ -
53	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në lagjen "Kurilla"	52612	€ 100,000.00	€ -	€ -
54	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në lagjen "Te kullat"	52627	€ 100,000.00	€ -	€ -
55	Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afer Kampusit Universitar vazhdim të rrjedhes	52118	€ 300,000.00	€ -	€ -
56	Ndërtimi i infrastrukturës në Muradem	Projekt i ri	€ 26,085.00	€ -	€ -
57	Ndërtimi i infrastrukturës në Kushnin Has,rrugët dhe kanalizimi	Projekt i ri	€ 23,038.00	€ -	€ -
58	Ndërtimi i infrastrukturës në Kabash Has,rrugët dhe kanalizimi	Projekt i ri	€ 11,799.27	€ -	€ -
59	Furnizimi me zhavor për rrugët e paasfaltuara	Projekt i ri	€ 52,266.00	€ -	€ -
60	Ndërtimi i rrugës Zym-Lugishtë e Hasit-Dedaj	Projekt i ri	€ 60,000.00	€ -	€ -
61	Furnizimi me montimi i gypave të energjetikës,kabllovikut etj në Qytetin e Prizrenit	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
62	Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsirës publike në zonën e par të mbrojtur	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
63	Rregullimi i ndriçimit publik në Lukijë	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ -	€ -
64	Rregullimi i ndriçimit publik në Mazrek	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ -	€ -
65	Projekte me participim me donator,Ministritë dhe OJQ	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ 200,000.00	€ 300,000.00
66	Rregullimi i udhëkryqeve në disa pjesë të qytetit	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ 150,000.00	€ 150,000.00
67	Rregullimi i mureve mbrojtëse në Komunën e Prizrenit	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ 200,000.00	€ 300,000.00
68	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Skorobisht	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
69	Rregullimi i trotuareve në pjesët kryesore të Qytetit	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ -	€ -
70	Rregullimi i përrockës në fshatin Randobravë	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
71	Rregullimi i shtratit të lumit në Lutogllavë	Projekt i ri	€ 70,000.00	€ -	€ -
72	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik përgjate Tranzitit të vjetër (KFORIT),	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
73	Ndërtimi i Muzeut dhe Galerisë së Arteve	Projekt i ri	€ 200,000.00	€ 500,000.00	€ 500,000.00
	<b>TOTALI SHERBIMET PUBLIKE - PRIZREN</b>		<b>€ 12,950,288.27</b>	<b>€ 13,290,099.47</b>	<b>€ 16,031,850.00</b>
	<b>ADMINISTRATA</b>				
1	Furnizimi me kompjutera dhe pajisje tjera	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 60,000.00	€ 65,000.00
2	Infografikat dhe sinjalizimet në objektet e K.K Prizren	Projekt i ri	€ 30,000.00	€ 35,000.00	€ 40,000.00
3	Renovimi i objekteve të K.K Prizren	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ 250,000.00	€ 230,000.00
4	Ndërtimi i vorrezave në Krushë të Vogel ( vazhdim i projektit )	Projekt i ri	€ 70,000.00	€ 20,000.00	€ 50,000.00
5	Ndërtimi i Memorialit në Krushë të Vogel ( vazhdimi i projektit )	Projekt i ri	€ 120,000.00	€ 20,000.00	€ 70,000.00
6	Blerja e 2 e- Kioskave për shërbime të Qytetareve	Projekt i ri	€ 30,000.00	€ 30,000.00	€ 40,000.00
	<b>Totali i Administratës</b>		<b>€ 400,000.00</b>	<b>€ 415,000.00</b>	<b>€ 495,000.00</b>
	<b>ZJARRFIKESIT</b>				
1	Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit	48539	€ 165,000.00	€ 165,000.00	€ 100,000.00
2	Ndërtimet e mureve mbrojtëse nga rrëshqitjet e dheut	55875	€ 65,000.00	€ 125,000.00	€ 100,000.00
3	Pajisje për brigadën e zjarri	52143	€ 70,000.00	€ 70,000.00	€ 70,000.00
4	Dron për shuarjen e zjarreve malore	49592	€ 50,000.00	€ 50,000.00	€ -
5	Motorra malor për kërkim shpëtim	53357	€ 50,000.00	€ 25,000.00	€ -



6	Vendosja e hidranteve në zonën Historike të Prizrenit	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 25,000.00	€ -
<b>Totali I Zjarrefikesve</b>			<b>€ 450,000.00</b>	<b>€ 460,000.00</b>	<b>€ 270,000.00</b>
<b>TURIZMI</b>					
1	Ndërtimi i Infrastrukturës (Rrugët Dhe Ambijenti) Turizmit Malor dhe Rural – <b>Nashec</b> , Jabllanicë, Vermicë	53438	€ 182,915.10	€ 100,000.00	€ 150,000.00
2	Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambijentit) turizmit kulturor -	53442	€ 157,113.10	€ 30,000.00	€ 30,000.00
3	Ndërtimi i infrastruktures në dy burimet e ujit në fshatin Vermicë	Projekt i ri	€ 60,000.00	€ 100,000.00	€ 100,000.00
4	Ndërtimi i Portës Triumfale (Muze)në lagjen Bajram Curr	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ 200,000.00	€ 300,000.00
5	Ndërtimi i infrastrukture rrugeve malore në rajonin e Sharrit (Zhupa), Zhur, Vërrinit, Hasit dhe Kabash-Korishë	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 100,000.00	€ 150,000.00
<b>Totali i Turizmit</b>			<b>€ 550,028.20</b>	<b>€ 530,000.00</b>	<b>€ 730,000.00</b>
<b>BUJQESIA</b>					
1	Rehabilitimi i rrugeve fushore	Projekt i ri	€ 210,000.00	€ 250,000.00	€ 280,000.00
2	Rehabilitimi i kanaleve kulluse dhe kullimi i tokave bujqesore	Projekt i ri	€ 160,000.00	€ 180,000.00	€ 200,000.00
3	Ndërtimi i strehimores për trajtimin e qenve endacak	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 80,000.00	€ -
4	Ndërtimi i Qendrës Agrare - (Shërbime Kshillimore, Trajnuese)	Projekt i ri	€ 80,000.00	€ 100,000.00	€ -
<b>Totali i Bujqesise</b>			<b>500,000.00</b>	<b>610,000.00</b>	<b>480,000.00</b>
<b>SHENDETESIA</b>					
1	Ndërtimi i QKMF-së në Kfor	51098	€ 380,000.00	€ 280,000.00	€ -
2	Paisje medicinale	89621	€ 30,000.00	€ 100,000.00	€ 100,000.00
3	Paisje stomatologjike	89622	€ 20,000.00	€ 50,000.00	€ 100,000.00
4	Paisje didaktike per trajnim	48475	€ -	€ 15,000.00	€ 30,000.00
5	Paisje Laboratorike	89626	€ -	€ 50,000.00	€ 50,000.00
6	Paisje jomedicinale	48493	€ 50,000.00	€ 100,000.00	€ 150,000.00
7	Mamografi	49286	€ 120,000.00	€ -	€ 150,000.00
8	Autoambulanca	48472	€ 150,000.00	€ 100,000.00	€ 200,000.00
9	Furnizim me inventar për zyre dhe ordianca	89620	€ 100,000.00	€ 200,000.00	€ 200,000.00
10	Ndërtimi i QMF-së në lagjen e Trimave (Tusuz)	Projekt i ri	€ 150,000.00	€ 500,000.00	€ 200,000.00
11	Instalimi dhe montimi i ngrohjes qendrore dhe klimatizimi eficient në objektet shëndetësore	Projekt i ri	€ 250,000.00	€ 250,000.00	€ 250,000.00
12	Digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike	Projekt i ri	€ 250,000.00	€ 100,000.00	€ 200,000.00
<b>Totali i Shendetesise :</b>			<b>1,500,000.00</b>	<b>1,745,000.00</b>	<b>1,630,000.00</b>
<b>SHERBIMET SOCIALE</b>					
1	Ndërtimi i banesave kolektive për familjet e dëshmorëve dhe rasteve sociale	45867	€ 50,000.00	€ 550,000.00	€ 450,000.00
2	Ndërtimi i Aneksit të Shtëpia Rezidenciale (salla për rekreacione fizike-sportive)	53608	€ 100,000.00	€ 85,000.00	€ 85,000.00
3	Ndërtimi i QPS2	48704	€ 100,000.00	€ 160,000.00	€ -
4	Blerja e automjetit per shtepine rezidenciale	49945	€ 40,000.00	€ -	€ -
5	Rregullimi i infrastrukturës për ndertesën e katër - Petrovë	48702	€ 20,000.00	€ 15,000.00	€ -
6	Blerja e vetures per Shtepine e Pleqve	53581	€ 30,000.00	€ -	€ -
7	Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijeve	53610	€ 230,000.00	€ 215,000.00	€ 215,000.00
8	Ndërtimi i shtëpisë së pleqëve	40718	€ 5,000.00	€ -	€ -
9	Vendosja e kamerave të sigurisë në objektet e DPMS-së (Arkivës), Shtëpisë rezidenciale, Shtëpisë së pleqve dhe Shtëpisë së qëndrimit ditore	Projekt i ri	€ 15,000.00	€ -	€ -
10	Ndërtimi i koridorit për lidhjen fizike në mes të objekteve të QPS-së dhe objektit të Arhivit si dhe vendosja e ashensorit për mundësimin e qasjes së përsnoave me aftësi të kufizuara në objektin e QPS-së	Projekt i ri	€ 60,000.00	€ -	€ -
<b>Totali Sherbimet sociale</b>			<b>650,000.00</b>	<b>1,025,000.00</b>	<b>750,000.00</b>
<b>URBANIZMI</b>					
1	Bashkefinancimi me MKRS- QRTK( ndertimi dhe plani per menaxhimin e qendres Historike	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 70,000.00	€ 80,000.00
2	Bashkefinancimi me MKRS-QRTK (ndertimi I rruges Marlin Barleti)	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 50,000.00	€ 50,000.00
<b>Totali i Urbanizmit</b>			<b>€ 100,000.00</b>	<b>€ 120,000.00</b>	<b>€ 130,000.00</b>
<b>ARSIMI</b>					



1	Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjanë" në Pllanjanë	40736	€ 59,746.60	€ -	€ -
2	Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek	40755	€ 150,000.00	€ 283,253.53	€ -
3	Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël	46665	€ 191,589.00	€ 200,000.00	€ -
4	Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasëshe) në Gjonaj të Hasit	48663	€ 24,779.20	€ -	€ -
5	Ndërtimi i aneksit të objektit të objektit shkollor Ardhmëria" në Landovicë	51175	€ 240,218.84	€ -	€ -
6	Ndërtimi i aneksit të shkolles ne Vermice	52153	€ 243,333.54	€ -	€ -
7	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen Jeta e Re - Prizren - faza e dytë	40780	€ 40,000.00	€ -	€ -
8	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen Bajram Curri - Prizren - faza e dytë	40777	€ 40,000.00	€ -	€ -
9	Ndërtimi i aneksit të shkolles se mesme ne Romajë - Has	53425	€ 140,000.00	€ -	€ -
10	Renovimi i teresishem i objektit shkollor "Gernqare" Novoselan	53428	€ 78,148.35	€ -	€ -
11	Rregullimi i ambientit të oborreve ne shkollat e Prizrenit	53862	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 150,000.00
12	Ndërtimi i aneksit të shkolles "Besim Ndrecaj" Lutogllave	53433	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 100,000.00
13	Renovimi i teresishem i objektit shkollor (aneksit te vjeter) "Naim Frasheri" Vlashne	53434	€ 30,000.00	€ -	€ -
14	Renovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren	53437	€ 100,000.00	€ -	€ -
15	Ndërtimi i qerdhes ne Lagjen Tusus Prizren	53443	€ 300,000.00	€ 300,000.00	€ 300,000.00
16	Ndërtimi i objektit të ri shkollor ne Lagjen "Bajram Curri" Prizren	53446	€ -	€ 50,000.00	€ 250,000.00
17	Ndërtimi i qerdhes ne Fshatin Zhur - Prizren	Projekt i ri	€ 50,000.00	€ 150,000.00	€ -
18	Renovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike, në SHFMU "Meto Bajraktari" ne Reqane - Prizren	46666	€ 68,612.00	€ -	€ -
19	Renovimi i nyjeve sanitare ne disa objektet shkollore: "Ibrahim Fehmiu", "Deshmoret e Kabashit"		€ -	€ 100,000.00	€ 150,000.00
20	Izolimi termik i fasades se objektit shkollor "Nazim Kokollari" Prizren	Projekt i ri		€ 50,000.00	€ -
21	Mirembajtja e sistemit te ngrohjeve qendrore neper shkolla	Projekt i ri	€ -	€ 100,000.00	€ 100,000.00
22	Renovimi i teresishem i objektit shkollor "Deshmoret e Zhurit" Zhur	Projekt i ri	€ -	€ 200,000.00	€ 50,000.00
23	Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Gjumnazi "Remzi Ademaj" në Prizren	Projekt i ri	€ -	€ 200,000.00	€ 200,000.00
24	Renovimi i teresishem i objekteve shkollore ne Gorozhup dhe Jeshkove	Projekt i ri	€ -	€ 150,000.00	€ -
25	Renovimi i teresishem i objektit parashkollor "Lidhja e Prizrenit" Prizren	Projekt i ri	€ -	€ 150,000.00	€ -
26	Adaptimi i hapësirës për laboratore dhe furnizimi me paisje, ne shkolla	Projekt i ri	€ -	€ 150,000.00	€ 200,000.00
27	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Mithat Frasheri" në Krajk	Projekt i ri	€ -	€ 150,000.00	€ 200,000.00
28	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Dy Deshmoret" në Piranë	Projekt i ri	€ -	€ 150,000.00	€ 200,000.00
29	Ndërtimi i dyerve dhe dritareve te SHFMU "Ibrahim Fehmiu" Arbane Prizren	Projekt i ri	€ -	€ -	€ 100,000.00
30	Ndërtimi i dyerve dhe dritareve te SHFNU "Pjeter Budi" Lubizhde Has	Projekt i ri	€ -	€ -	€ 100,000.00
31	Ndërtimi i dyerve dhe dritareve te SHFMU "Haziz Tola" Prizren	Projekt i ri			€ 100,000.00
32	Ndërtimi i objektit të ri shkollor ne Zym te Hasit	Projekt i ri	€ -	€ -	€ 500,000.00
33	Renovimi i SEF te SHMU "Hysen Rexhepi" Prizren	Projekt i ri	€ -	€ -	€ 150,000.00

**Totali i Arsimit**

€ 2,056,427.53 € 2,683,253.53 € 2,850,000.00

**KULTURA**

1	Renovimi i Qendrës Sportive "Sezai Surroi" në Prizren (nxemja)	51162	€ 170,000.00	€ -	€ -
2	Ndërtimi i objekteve sportive dhe kulturore në qytet dhe fshatra	53853	€ 100,000.00	€ 500,000.00	€ 500,000.00
3	Ndërtimi i bibliotekës ndërkomunale	Projekt i ri	€ 200,000.00	€ 200,000.00	€ 200,000.00
4	Qendër sportive "Sezai Surroi" izolimi i jashtëm	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ -	€ -
5	Ndërtimi i memorialit "Xhavit Elshani" - Leopardi	53854	€ 23,000.00	€ -	€ -
6	Renovimi i shtepise se kulturës në Gjonaj	Projekt i ri	€ 100,000.00	€ 200,000.00	€ -
7	Ndërtimi i stadiumit Has Arena - Kabash Has	53618	€ 100,000.00	€ 300,000.00	€ 300,000.00
8	Ndërtimi i varrezave te martireve ne Landovicë	53628	€ 100,000.00	€ 100,000.00	€ -
9	Ndërtimi i salles Multifunkionale	49873	€ 200,000.00	€ 200,000.00	€ 100,000.00



10	Kulla e "Remzi Ademaj" Zhur	53622	€ 100,000.00	€ 50,000.00	€ -
<b>Totali i Kultures</b>			€ 1,193,000.00	€ 1,550,000.00	€ 1,100,000.00
<b>FINANCA</b>					
1	Rinovimi i Eficiences se energjise te ndertesave Publike ne Prizren (Adminstrates Komunale, Shkollat, Qerdhet, QKMF-te, AMF-te etj)	53873	€ 5,000.00	€ 5,000.00	€ -
<b>Total Financa</b>			€ 5,000.00	€ 5,000.00	€ -